

RELACION I PROJEKTLIGJIT

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 162/2014, “PËR MBROJTJEN E CILËSISË SË AJRIT NË MJEDIS”, I NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Menaxhimi, monitorimi dhe mbrojtja e cilësisë së ajrit në Republikën e Shqipërisë përbën një prioritet strategjik, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në kuadër të procesit të integritit evropian. Kuadri aktual ligjor, i përcaktuar nga ligji nr.162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” i ndryshuar, kërkon përmirësim të mëtejshëm për të siguruar përputhshmëri të plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian.

Në këtë kontekst, projektligji synon transpozimin e pjesshëm në legjislacionin shqiptar të Direktivës 2024/2881/KE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2024, “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër për Evropën, duke vendosur një kuadër të qartë për menaxhimin dhe monitorimin e cilësisë së ajrit në mjedis.

Për shkak të natyrës teknike dhe volumit të dispozitave të Direktivës (BE) 2024/2881, transpozimi i plotë i saj realizohet nëpërmjet këtij projektligji dhe akteve nënligjore zbatuese që do të miratohen në zbatim të nenit 22 të ligjit. Këto akte do të përcaktojnë standardet e cilësisë së ajrit, metodologjitë e monitorimit dhe vlerësimit, kriteret për klasifikimin e zonave dhe aglomerateve, organizimin e rrjetit të monitorimit, funksionimin e superstacioneve të monitorimit, si dhe kërkesa të tjera teknike të parashikuara nga Direktiva (BE) 2024/2881.

Përmes këtyre ndryshimeve, projektligji synon të krijojë një sistem më efektiv dhe të integruar për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, duke forcuar përgjegjësinë e institucioneve publike dhe përfshirjen e publikut, si dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit, mjedisit në përgjithësi dhe të jetës së qytetarëve, në përputhje me standardet dhe objektivat e Bashkimit Evropian.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Kapitulli i mjedisit është një nga kapitujt e rëndësishëm në kuadër të procesit të integritimit, detyrimet e të cilit përcaktohen në nenin 70/3 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që parashikon domosdoshmërinë e përafrimit të legjislacionit vendas me “*acquis communautaire*”. Për shkak të rëndësisë që ka mbrojtja e mjedisit, MSA-ja përmban një nen të posaçëm për mjedisin, Nenin 108, ku përcaktohet bashkëpunimi në luftën kundër degradimit mjedisor me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore, nëpërmjet përafrimit me (Acquis e BE-së) në fushën e mjedisit.

Miratimi i këtij projektligji është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Akteve të Ministrisë së Mjedisit dhe Programin Kombëtar të Integritimit European (PKIE) për vitin 2026, dhe është në përputhje edhe me Programin Politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Fusha e mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi dhe mbrojtja e cilësisë së ajrit në vecanti në Republikën e Shqipërisë ka pësuar zhvillime të rëndësishme gjatë viteve të fundit, në funksion të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”. Megjithatë, kuadri aktual ligjor, i përcaktuar nga ligji nr.162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” i ndryshuar, nuk reflekton plotësisht zhvillimet më të fundit të *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e cilësisë së ajrit në lidhje me monitorimin e cilësisë së ajrit, përcaktimin e metodologjive dhe zbatimin masave në rastet e tejkalimit të niveleve të përcaktuara të ndotësve.

Direktiva (BE) 2024/2881 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2024, ka vendosur standarde të reja dhe kërkesa më të avancuara për monitorimin, vlerësimin, planifikimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit. Për këtë arsye, është e nevojshme përditësimi i kuadrit ligjor kombëtar për të siguruar bazën e nevojshme ligjore për transpozimin dhe zbatimin e këtyre kërkesave.

Projektligji adreson disa mangësi të evidentuara në legjislacionin aktual, ndër të cilat:

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.162/2014 l “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit”, i ndryshuar”

- a) mungesën e disa përkufizimeve dhe koncepteve të reja të parashikuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian;
- b) nevojën për forcimin e planifikimit të cilësisë së ajrit përmes planeve të cilësisë së ajrit;
- c) Lista e ndotësve të ajrit dhe kuadri ligjor për monitorimin e tyre, të cilat nuk janë përafruar plotësisht me Direktivën (BE) 2024/2881. Projektligji zgjeron listën e ndotësve objekt rregullimi dhe krijon bazën ligjore për përcaktimin e standardeve të cilësisë së ajrit me aktet nënligjore përkatëse.
- ç) monitorimi, nga ku aktualisht monitorimi i cilësisë së ajrit mbetet i përqendruar kryesisht në Tiranë, me stacione që matin kryesisht PM10, PM2.5 dhe NO2 të lidhura me trafikun. Direktiva e re kërkon supersite, shton listën e ndotësve si dhe përcakton një mbulim gjeografik më të gjërë nga ku përveç zonave urbane përfshin edhe ato me sfond rural;
- d) modelimi, pasi legjislacioni aktual nuk parashikon detyrim për modelim atmosferik por fokusohet në vlerësimin nëpërmjet matjeve direkte, pa e bërë modelimin element të detyrueshëm të sistemit të vlerësimit. Ndërkohë Direktiva 2024/2881/KE e bën modelimin të detyrueshëm, veçanërisht aty ku tejkalohen vlerat limite.

Ndryshimet e propozuara pritet të sjellin përmirësime të rëndësishme në sistemin kombëtar të monitorimit dhe menaxhimit të cilësisë së ajrit. Nëpërmjet zgjerimit të kuadrit rregullator dhe përafrimit me standardet evropiane, do të përmirësohet cilësia dhe besueshmëria e informacionit mbi cilësinë e ajrit, do të rritet efektiviteti i masave parandaluese dhe korrigjuese ndaj ndotjes, si dhe do të forcohet koordinimi ndërinstitucional në nivel qendror dhe vendor.

Gjithashtu, projektligji pritet të kontribuojë në mbrojtjen më të mirë të shëndetit të njeriut dhe të mjedisit, në rritjen e transparencës dhe të pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimmarrëse, si dhe në përmbushjen e detyrimeve që Shqipëria ka në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe është harmonizuar me legjislacionin kombëtar në fuqi, konkretisht me ligjin kuadër nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative, legjislacionin për të drejtën e informimit, legjislacionin për

njoftimin dhe konsultimin publik, si dhe legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

Projektligji është gjithashtu në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e mjedisit dhe me angazhimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, lidhur me përafrimin progresiv të legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire* në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Dispozitat e projektligjit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Direktivës (BE) 2024/2881 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2024, “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër për Evropën”, si dhe me parimet e Konventës së Aarhusit për aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe aksesin në drejtësi në çështjet mjedisore.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji synon përafrimin e pjesshëm të legjislacionit kombëtar me Direktivën (BE) 2024/2881 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2024, “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër për Evropën” (CELEX 32024L2881), e cila përbën aktin kryesor të Bashkimit Evropian në fushën e vlerësimit, monitorimit dhe menaxhimit të cilësisë së ajrit;

Gjithashtu, dispozitat e projektligjit janë në përputhje me kuadrin më të gjerë të legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e ndotjes së ajrit dhe kontrollit të emetimeve, veçanërisht me:

- Direktivën (BE) 2016/2284 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 dhjetor 2016, “Për reduktimin e emetimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë” (CELEX 32016L2284);
- Direktivën 1999/13/EC të Këshillit, datë 11 mars 1999, “Për kufizimin e emetimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC) që rezultojnë nga përdorimi i tretësve organikë në disa aktivitete dhe instalime” (CELEX 31999L0013);
- Direktivën 2004/42/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 prill 2004, “Për kufizimin e emetimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC) për shkak të përdorimit të tretësve organikë në disa bojëra dhe llaqe dhe në produktet për rifiniturimin e automjeteve” (CELEX 32004L0042);
- aktet e tjera të *acquis* të Bashkimit Evropian që rregullojnë cilësinë e ajrit, kontrollin e emetimeve atmosferike dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit.

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.162/2014 l “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit”, i ndryshuar”

Shkalla e përafrimit të realizuar me Direktivën (BE) 2024/2881 paraqitet në mënyrë të detajuar në Tabelën e Përputhshmërisë (TPI), e cila shoqëron projektligjin.

Për shkak të natyrës teknike të Direktivës (BE) 2024/2881, transpozimi i plotë i saj nuk realizohet vetëm nëpërmjet këtij projektligji, por edhe nëpërmjet akteve nënligjore zbatuese që do të miratohen në zbatim të tij. Shkalla e përafrimit dhe dispozitat konkrete të acquis që transpozohen me këtë projektligj paraqiten në Tabelën e Përputhshmërisë (TPI), e cila shoqëron projektaktin.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.

Projektligji synon të krijojë një sistem më efektiv dhe të integruar për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, duke forcuar përgjegjësinë e institucioneve publike dhe përfshirjen e publikut, si dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit, mjedisit në përgjithësi dhe të jetës së qytetarëve, në përputhje me standardet dhe objektivat e Bashkimit Evropian.

Projektligji përmban 11 nene. Konkretisht:

Neni 1 parashikon ndryshimin e disa përkufizimeve ekzistuese dhe shtimin e 19 përkufizimeve të reja, të lidhura me standardet e cilësisë së ajrit, monitorimin, modelimin, ekspozimin e popullsisë, planifikimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Neni 2 ndryshon nenin 5 të ligjit, duke zgjeruar bazën ligjore për vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe duke parashikuar krijimin e superstacioneve të monitorimit në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian.

Neni 3 ndryshon nenin 7 të ligjit, duke rregulluar në mënyrë më të detajuar Strategjinë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit, Planin Kombëtar të Cilësisë së Ajrit, planet e cilësisë së ajrit, udhërrëfyesit për cilësinë e ajrit dhe planet afatshkurtra të veprimit.

Neni 4 forcon kuadrin e informimit të publikut përmes publikimit të indeksit të cilësisë së ajrit dhe informacionit mbi ndikimet shëndetësore të ndotjes së ajrit dhe masat mbrojtëse për popullsinë.

Neni 5 shton nenet 10/1 dhe 10/2, të cilat rregullojnë administrimin e të dhënave të cilësisë së ajrit nëpërmjet Sistemit të Integruar Mjedisor (SIM) dhe garantojnë të drejtën e ankimit administrativ dhe gjyqësor për publikun dhe organizatat e interesuara.

Neni 6 ndryshon nenin 18 të ligjit, duke parashikuar identifikimin e zonave të prekura nga ndotja ndërkufitare e ajrit dhe forcimin e bashkëpunimit me shtetet fqinje për monitorimin dhe shkëmbimin e të dhënave.

Neni 7 shton nenin 19/1, i cili parashikon të drejtën e kompensimit për dëmet ndaj shëndetit të njeriut si pasojë e shkeljeve serioze të detyrimeve të përcaktuara në ligj, si dhe rregullon kushtet dhe afatet për ushtrimin e kësaj të drejte.

Neni 8 përcakton afatet për miratimin e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit.

Neni 9 rregullon shfuqizimin e akteve nënligjore ekzistuese pas miratimit të akteve të reja zbatuese.

Neni 10 përmban dispozitat kalimtare që sigurojnë vijimësinë juridike të planeve, strategjive, lejeve dhe procedurave administrative ekzistuese deri në përshtatjen e tyre me kuadrin e ri ligjor.

Neni 11 përcakton hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Projektligji shoqërohet me tre anekse, të cilat përbëjnë pjesë integrale të projektligjit dhe përcaktojnë kërkesat e detajuara për monitorimin, vlerësimin, planifikimin dhe informimin e publikut në fushën e cilësisë së ajrit. Konkretisht:

Aneksi I, përcakton listën e ndotësve të ajrit që janë objekt i zbatimit të ligjit, duke i klasifikuar sipas standardeve të cilësisë së ajrit dhe kërkesave për monitorim e vlerësim. Gjithashtu, parashikohet mundësia e përditësimit të kësaj liste me akte nënligjore, në përputhje me zhvillimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Aneksi II, përcakton përmbajtjen minimale të planeve të cilësisë së ajrit, udhërrëfyesve të cilësisë së ajrit dhe planeve afatshkurtra të veprimit. Ajo rregullon informacionin që duhet të përfshihet për vlerësimin e ndotjes, identifikimin e burimeve, përcaktimin e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit, monitorimin e zbatimit të tyre.

Aneksi III, përcakton kërkesat për informimin e publikut mbi cilësinë e ajrit, duke specifikuar informacionin që duhet të publikohet për gjendjen e cilësisë së ajrit, tejkalimet e standardeve, ndikimet në shëndetin e njeriut dhe mjedis, masat parandaluese, si dhe mënyrat dhe format për shpërndarjen e këtij informacioni në kohë, në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme për publikun.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Ministria përgjegjëse për mjedisin, Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera publike që ushtrojnë kompetenca në fushat që ndikojnë në cilësinë e ajrit.

Ministria përgjegjëse për mjedisin është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe koordinimin e politikave kombëtare në fushën e cilësisë së ajrit, për përgatitjen e akteve nënligjore dhe dokumenteve strategjike të parashikuara nga ky ligj, si dhe për bashkëpunimin ndërinstitutional dhe ndërkufitar në fushën e mbrojtjes së cilësisë së ajrit.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ajrit, administrimin dhe përpunimin e të dhënave, funksionimin e sistemit të informacionit për cilësinë e ajrit në kuadër të Sistemit të Integruar Mjedisor (SIM), si dhe për raportimin e të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të cilësisë së ajrit, planeve afatshkurtra të veprimit dhe masave të tjera vendore për përmirësimin e cilësisë së ajrit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Në zbatimin e dispozitave të ligjit përfshihen gjithashtu institucionet publike, operatorët ekonomikë dhe subjektet e tjera të autorizuar, të cilat janë të detyruara

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.162/2014 i "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit", i ndryshuar"

të sigurojnë, raportojnë dhe shkëmbejnë të dhëna që lidhen me cilësinë e ajrit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Mjedisit, me asistencën teknike të projektit “Environment Support Programme Albania” (ESP), në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e cilësisë së ajrit.

Gjatë procesit të hartimit, projektligji është konsultuar me strukturat përgjegjëse brenda Ministrisë së Mjedisit, si dhe me institucionet publike përgjegjëse për sektorët që lidhen me mbrojtjen e cilësisë së ajrit, shëndetin publik, energjinë, transportin dhe zhvillimin ekonomik.

Nëpërmjet sistemit elektronik e-Akte, projektligji do t'i përcillet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Komentet dhe sugjerimet e paraqitura nga institucionet pjesëmarrëse janë shqyrtuar dhe, sipas rastit, janë reflektuar në tekstin e projektligjit. Gjithashtu do të përcillet edhe pranë Agjencisë së Vetëqeverisjes Vendore.

Në zbatim të ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJKP), duke iu nënshtruar procedurave të konsultimit publik në afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Ministria e Mjedisit ka zhvilluar gjithashtu një proces të zgjeruar konsultimi me institucionet publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore, përfaqësues të komunitetit të biznesit, organizatat e shoqërisë civile, komunitetin akademik dhe partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit.

Në kuadër të këtij procesi janë organizuar disa takime konsultative dhe tryeza diskutimi kushtuar transpozimit të Direktivës (BE) 2024/2881 për cilësinë e ajrit në mjedis dhe paketës ligjore që lidhet me zbatimin e saj. Diskutimet janë fokusuar në përmirësimin e sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit, forcimin e rolit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, bashkëpunimin ndërinstitucional, informimin dhe pjesëmarrjen e publikut, si dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian. Sugjerimet e marra gjatë procesit të konsultimit janë vlerësuar dhe reflektuar në përmbajtjen e projektligjit, veçanërisht në dispozitat

Relation shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.162/2014 l “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit”, i ndryshuar”

që lidhen me monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit, planifikimin e masave për përmirësimin e saj, sistemin e informacionit, pjesëmarrjen e publikut dhe koordinimin institucional.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektligjit kërkon miratimin e akteve nënligjore përkatëse, përmes të cilave do të përcaktohen standardet e cilësisë së ajrit, metodologjitë e vlerësimit, kërkesat për monitorimin dhe funksionimin e superstacioneve të monitorimit, si dhe organizimi i sistemit të raportimit dhe administrimit të të dhënave për cilësinë e ajrit.

Projektligji nuk parashikon shpenzime shtesë të drejtpërdrejta për buxhetin e shtetit. Kostot për zbatimin e masave të parashikuara në projektligj do të përballohen në përputhje me planifikimet buxhetore afatmesme të institucioneve përgjegjëse dhe, sipas rastit, nëpërmjet asistencës financiare të programeve dhe instrumenteve të Bashkimit Evropian dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë.

Vlerësimi i detajuar i ndikimeve financiare, institucioneve përfituese dhe alternativave të financimit është paraqitur në dokumentin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA), që shoqëron projektligjin.

MINISTRI

Sofjan JAUPAJ

**Sofjan
Jaupaj**

Digitally signed by
Sofjan Jaupaj
Date: 2026.07.17
11:09:50 +02'00'

